



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 279, Datë 06.11.2025

MBI

**MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN E GATISHMËRISË SË
TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË DITËS NË AVANCË**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 30, pika 5, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; si dhe neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2777 prot., datë 04.11.2025, të Drejtorisë së Politikave të Burimeve të Rinovueshme dhe Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi miratimin e Metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë së ditës në avancë.”,

Konstatoi se:

1. Fillimi i procedurës për miratimin e metodologjisë

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 256, datë 02.12.2024, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë së ditës në avancë (DAM)”, në funksion të konvertimit të marrëveshjeve për blerjen e energjisë (MBE) në kontrata për diferencë (KpD), sipas ligjit nr. 24/2023.

2. Konsultimi publik dhe njoftimi i palëve

- Draft-metodologjia më datë 03.12.2024 është publikuar në faqen zyrtare të ERE-s, në seksionin “Konsultime”, me qëllim mbledhjen e komenteve nga palët e interesit.
- Me shkresën nr. 2473/1 prot., datë 11.12.2024, janë njoftuar: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Bursa shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX sh.a., Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA), Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a., si dhe palë të tjera të interesuara, në lidhje me publikimin e draft-metodologjisë në faqen zyrtare të ERE-s për konsultim publik dhe me qëllim mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve të tyre në kuadër të procesit të miratimit të dokumentit.
- Drafti i është përcjellë me e-mail edhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për komente, në kuadër të përfshirjes së tij si palë e interesuar në procesin e konsultimit ndërinstitucional.

3. Seanca dëgjimore

- Në zbatim të urdhrit të Kryetarit të ERE-s nr. 96, datë 26.06.2025, më datë 03.07.2025 u zhvillua një seancë dëgjimore me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ALPEX sh.a., FTL sh.a.,

AAES dhe Drejtorive Teknike të ERE-s (palë të tjera të ftuara që nuk u paraqitën: MIE dhe AREA).

- Gjatë seancës u diskutuan dy propozime të paraqitura nga ALPEX sh.a. lidhur me draft-metodologjinë:
- ALPEX kërkoi të qartësohej nëse raporti 6-mujor mbi gatishmërinë do të hartohet vazhdimisht, apo vetëm gjatë periudhës kur tregu vlerësohet jo i gatshëm nga ERE. U sqarua nga ERE se raportimi 6-mujor zbatohet vetëm në periudhën kur vlerësimi rezulton negativ dhe ky sqarim do të reflektohet në dokument.
- ALPEX propozoi që emërues në formulë të merret vetëm konsumi i tregut të liberalizuar, duke përjashtuar klientët në tension të ulët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal. Pas shqyrtimit me konsulentin, u vlerësua se ky propozim nuk mund të pranohej, pasi përlllogaritja e faktorit të qarkullimit duhet të bëhet sipas metodologjisë së ACER, e përdorur nga të gjitha vendet anëtare të BE-së, për të siguruar krahasueshmëri ndërkombëtare. U theksua se analiza e likuiditetit të tregut DAM bazohet në një qasje holistike të treguesve dhe nuk mbështetet vetëm në një parametër të vetëm për përcaktimin e gatishmërisë për CfD.

4. Rekomandime/komente të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe sqarimet e konsulentit

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, përmes e-mailit të datës 22.10.2025, vlerësoi se draft-metodologjia i referohej nenit 30, pika 5 të ligjit nr. 24/2023, ndërkohë që referenca më e saktë ishte pika 4 e të njëjtit nen, pasi ajo lidhet drejtpërdrejt me burimet alternative të tregut. Zyra e konsulencës ka pranuar këtë koment dhe ka reflektuar riformulimin përkatës në draft-metodologji.
- Sekretariati evidentoi se metodologjia nuk kishte përfshirë në mënyrë të plotë kriteret dhe treguesit mbi integritetin dhe transparencën. Në vijim, konsulenti propozoi zgjerimin e nenit 5 të draft-metodologjisë, duke shtuar një pikë të re (pika 4), sipas së cilës ERE do të vlerësojë aplikimin dhe zbatueshmërinë e rregullave për integritetin dhe transparencën në tregun shqiptar të ditës në avancë, duke u mbështetur në Rregulloren REMIT dhe kuadrin rregullator të Komunitetit të Energjisë. Ky vlerësim do të përfshijë elemente si: regjistrimi dhe sjellja e pjesëmarrësve të tregut sipas kërkesave të ALPEX dhe REMIT; publikimi i të dhënave të tregut dhe njoftimeve urgjente, si dhe aplikimi i praktikave më të mira të transparencës pas-tregtimit; administrimi dhe pavarësia e ALPEX, duke përfshirë vlerësimin e procedurave të transparencës dhe detyrimeve për raportim; monitorimi dhe parandalimi i manipulimeve të tregut dhe tregtimit me informacion të brendshëm, përfshirë mekanizmat efektivë të hetimit dhe penalizimit.
- Në nenin 5, pika 1, gërma b), draft-metodologjia theksonte se faktori i qarkullimit është zakonisht më i vogël se 1. Sekretariati vlerësoi se kjo shprehje nuk është e nevojshme, pasi koeficienti mund të jetë teorikisht edhe më i lartë se 1, dhe propozoi heqjen e saj. Konsulenti dhe ERE e pranuan këtë koment dhe e reflektuan duke fshirë frazën përkatëse.
- Sekretariati sugjeroi që përdorimi i treguesit të diferencës ofertë-kërkesë mund të mos jetë i përshtatshëm në një treg të bazuar mbi ankande si DAM, pasi ky tregues përdoret kryesisht në tregjet me tregtim të vazhdueshëm dhe mund të mos ofrojë matje reale të likuiditetit. Konsulenti sqaroi se ky tregues, edhe pse me kufizime, mbetet i rëndësishëm për vlerësimin gjithëpërfshirës të gatishmërisë, sidomos në procesin e kalimit nga marrëveshjet për blerjen e energjisë (MBE) në kontrata për diferencë (KpD). Ai do të përdoret nga ERE në rastet kur të dhënat janë të disponueshme, duke shoqëruar rezultatet me analiza cilësore mbi kufizimet. E njëjta logjikë aplikohet edhe për treguesin e “thellësisë së tregut”.

- Në nenin 6, pika 2, gërma a), Sekretariati kërkoi sqarime për aplikimin e treguesit mbi disponueshmërinë e çmimeve DAM. Konsulenti konfirmoi se ky tregues zbatohet për çdo periudhë shlyerjeje, në përputhje me nenin 30, pika 4 të ligjit nr. 24/2023.
- Në nenin 6, pika 2, gërma e), Sekretariati kërkoi që vlerësimi të përfshijë automatikisht vëllimet e tregtuara në tregun e Kosovës, pasi Shqipëria dhe Kosova operojnë si treg i bashkuar, duke marrë parasysh kufizimet e kapaciteteve ndërkufitare. Konsulenti sqaroi se metodologjia do të trajtojë të dy tregjet si një treg të vetëm në periudhat kur nuk ka kongjestione dhe ndajnë të njëjtin çmim DAM. Në rastet kur mungojnë të dhënat e plota për ndërtimin e kurbave të përbashkëta të kërkesës dhe ofertës, ERE do të aplikojë një vlerësim cilësor, duke krahasuar tregun e bashkuar me tregje të ngjashme të BE-së që funksionojnë si tregje të pavarura.

5. Përmbajtja dhe treguesit e metodologjisë

- Për vlerësimin e gatishmërisë, ERE do të analizojë nëse janë përmbushur këto kushte: ekziston një bursë operationale DAM që ofron çmime referente për të gjitha periudhat e shlyerjes për një periudhë 10-mujore të pandërprerë; janë duke u zbatuar parimet dhe rregullat për integritetin dhe transparencën e tregut sipas kuadrit REMIT; vëllimet e tregtuara në DAM janë në nivel të krahasueshëm me tregjet homologe të BE-së.
- Treguesit mbi të cilët mbështetet vlerësimi janë: Disponueshmëria e çmimeve DAM (sinjali i çmimit për 10 muaj radhazi); Faktori i qarkullimit (raporti i energjisë së tregtuar ndaj konsumit total), i cili mat aktivitetin dhe likuiditetin relativ të tregut.
- Të dhënat do të sigurohen kryesisht nga ALPEX, si dhe nga burime krahasuese të BE-së.
- Përveç treguesve kryesorë, metodologjia parashikon edhe përdorimin e faktorëve shtesë si diferenca ofertë–kërkesë dhe thellësia e tregut, të cilët merren në konsideratë vetëm kur të dhënat janë të disponueshme dhe të krahasueshme me tregjet e BE-së.
- Metodologjia përcakton gjithashtu kriteret për hartimin e raportit të ERE-s mbi gatishmërinë e tregut, duke përfshirë afatet e raportimit si dhe mënyrën e përzgjedhjes së vendeve të BE-së që shërbejnë si tregje referencë për krahasim.
- Në pjesën përfundimtare, metodologjia parashikon rishikimin dhe ndryshimin e saj kur është e nevojshme si dhe hyrjen në fuqi menjëherë pas miratimit nga bordi i ERE-s.

6. Vlerësimet të ERE-s

- Është e arsyeshme dhe e domosdoshme për qartësi ligjore dhe efektivitet rregullator përfshirjen në metodologji të faktorëve:
 - a) Disponueshmërisë së çmimeve DAM për një periudhë të njëpasnjëshme 10-mujore;
 - b) Faktorit të qarkullimit (raporti i volumit të tregtuar në DAM ndaj konsumit total), të llogaritur sipas metodologjisë së publikuar nga ACER, për qëllime krahasimi ndërkufitar;
 - c) Kërkesave të integritetit dhe transparencës (REMIT), si kusht i pashmangshëm për vlerësimin e gatishmërisë;
 - d) Trajtimit të tregut të bashkuar Shqipëri–Kosovë si një treg i vetëm kur nuk ka kongjestione dhe ndajnë të njëjtin çmim DAM, si dhe aplikimit të vlerësimeve cilësore kur kufizimet e të dhënave pengojnë ndërtimin e kurbave të përbashkëta.
- Lidhur me propozimin e ALPEX për përdorimin e konsumit në tregun e liberalizuar si emërues në faktor qarkullimi, ERE – në përputhje me rekomandimin e konsulentit vlerëson të mos e pranojë ndryshimin, me qëllim ruajtjen e krahasueshmërisë ndërkombëtare sipas praktikës së ACER.

- Raporti periodik 6-mujor i ERE-s, pas kryerjes së vlerësimit të parë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e metodologjisë, do të hartohet vetëm për periudhën kur vlerësimi rezulton negativ; pas një vlerësimi pozitiv të gatishmërisë, raportimi periodik sipas kësaj metodologjie nuk kërkohet më.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e “Metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë elektrike së ditës në avancë.”. (Bashkëlidhur)
2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë palët e interesit, përfshirë MIE, ALPEX sh.a., OST sh.a., AAES, AREA, FTL sh.a. dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN E GATISHMËRISË SË TREGUT
SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË DITËS NË AVANCË

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo metodologji përcakton parimet dhe treguesit të cilët do të merren në konsideratë nga ERE për vlerësimin e gatishmërisë së tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike, mbështetur në përcaktimet e ligjit nr. 24/2023 *“Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”*.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo metodologji hartohet në mbështetje të pikës 5 të nenit 30 të ligjit nr. 24/2023 *“Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”* si dhe neneve 18, pika 1, gërma “a” dhe 20, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, i ndryshuar.

Neni 3
Përkufizime

1. Në këtë metodologji termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
 - **“Enti Rregullator i Energjisë”** ose **“ERE”** është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në Shqipëri.
 - **“Kontratë për diferencë” (KpD)** është një kontratë për mbështetje, e rregulluar financiarisht, ku Operatori i Energjisë së Rinovueshme i paguan prodhuesit me përparësi diferencën midis çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës kur çmimi i referencës është më i ulët se çmimi i garantuar dhe prodhuesi me përparësi i paguan diferencën Operatorit të Energjisë së Rinovueshme kur çmimi i referencës është më i lartë se çmimi i garantuar.
 - **“Marrëveshja e blerjes së energjisë (MBE)”** është një marrëveshje për mbështetje, ku OER garanton blerjen fizike të detyrueshme të energjisë elektrike të gjeneruar nga prodhuesit për një çmim fiks.
 - **“Konvertimi KpD”** është konvertimi i një marrëveshje për blerjen e energjisë në një kontratë për diferencë, në përputhje me nenin 30 pika 4, të ligjit nr. 24/2023 *“Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”*.

Miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 06.11.2025

- **Bursa Shqiptare e Energjisë** është entiteti përgjegjës për menaxhimin dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike me shumicë në Shqipëri në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar.
 - **“Tregu i Ditës në Avancë”** është tregu i energjisë elektrike ku dorëzimi i Urdhërporosive të Blerjeje dhe Shitjeje të vendosura në ditën para livrimit në intervalin prej Kohës së Hapjes së Portës deri në Kohën e Mbylljes së Portës
 - **“ACER”** është agjencia për bashkëpunimin e rregullatorëve të energjisë të Bashkimit Europian.
2. Termat, përkufizimet e të cilave nuk renditen në pikën 1 të këtij neni, marrin për referencë termat dhe përkufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

PJESA II

PARIMET E METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN E GATISHMËRISË SË TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË DITËS NË AVANCË

Neni 4

Parimet bazë të metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë elektrike të ditës në avancë

1. Vlerësimi i gatishmërisë së tregut nga ERE do të përfshijë vetëm tregun e ditës në avancë të energjisë elektrike, meqenëse ky vlerësim lidhet me konvertimin e marrëveshjeve për blerjen e energjisë (MBE) në kontrata për diferencë (KpD).
2. Në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë metodologji, ERE duhet të vlerësojë nëse kriteret e mëposhtme janë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme:
 - a) është krijuar një bursë operationale e energjisë elektrike që ofron çmime reference për periudhën përkatëse të shlyerjes për tregun e ditës në avancë për një periudhë të njëpasnjëshme 10-mujore;
 - b) janë duke u zbatuar parimet dhe rregullat për integritetin dhe transparencën e shitjes së energjisë në treg, përfshirë për personat që organizojnë profesionalisht transaksione;
 - c) vëllimet e tregtuara në tregun e një dite në avancë në lidhje me madhësinë fizike të tregut janë në një nivel të krahasueshëm me vëllime të tilla në disa tregje të ditës në avancë në vende të Bashkimit Europian.
3. ERE në përgatitjen e vlerësimit të gatishmërisë së tregut të ditës në avancë, do të marrë parasysh tregun e bashkuar Shqipëri – Kosovë, gjatë periudhave kur të dy tregjet kanë qenë të bashkuara dhe kanë prodhuar rezultate.
4. ERE ka të drejtë të përzgjedhë disa tregje të ditës në avancë në Bashkimin Europian për të kryer një vlerësim krahasimor të përshtatshëm dhe të marrë në konsideratë metodologjitë e përdorura nga ACER për vlerësimin e gatishmërisë së tregut.
5. ERE do të kërkojë nga Bursa Shqiptare e Energjisë dhëna të detajuara mbi ofertat, çmimet dhe vëllimet e tregut të ditës në avancë si edhe të dhëna krahasuese nga vendet e përzgjedhura për të kryer vlerësimin duke përdorur treguesit e përzgjedhur dhe karakteristikat e tregut.
6. Përveç vlerave të treguesve të llogaritura dhe të publikuara nga ACER, ERE do të përdorë të dhëna të publikuara nga autoritetet rregullatore të vendeve krahasuese përkatëse dhe nga vetë bursat e energjisë elektrike. Në rastet kur ERE ka nevojë për të dhëna konfidenciale

Miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 06.11.2025

që nuk janë publikisht të disponueshme për të kryer vlerësimin e gatishmërisë së tregut, ajo do të duhet t'i marrë ato nga rregullatorët apo bursat e tjera të energjisë.

7. ERE do të organizojë një këshillim publik me palët e interesuara në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë së tregut dhe do të publikojë një raport të këtij vlerësimi së bashku me gjetjet e saj.

Neni 5

Treguesit për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë elektrike të ditës në avancë ERE në përgatitjen e raportit për vlerësimin e gatishmërinë e tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike, duhet të marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

- a) **Disponueshmëria e çmimeve të tregut të ditës në avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë**, e cila nënkupton marrjen e një sinjali të pandërprerë të çmimit të tregut të ditës në avancë nga bursa e energjisë elektrike për një periudhë 10-mujore.
- b) **Faktori i qarkullimit**, i cili përcaktohet si sasia e energjisë elektrike të tregtuar në një treg krahasuar me konsumin total. Në kontekstin e Tregut të Ditës në Avancë (DAM), faktori i qarkullimit ofron një tregues të sasisë së tregtisë në bursën e energjisë elektrike në raport me madhësinë fizike të tregut. Llogaritja e faktorëve të qarkullimit në tregun shqiptar do të kërkojë të dhëna mbi vëllimet e tregtuara në Tregun e Ditës në Avancë dhe konsumin orar të energjisë në zonat relevante të tregut. Ky faktor do të përcaktohet nëpërmjet njërës nga mënyrat e mëposhtme:

$$\sum_h \frac{\text{Volumi i Tregtimit DAM në orën } h}{\text{Konsumi në orën } h}$$

ose

$$\frac{\sum_h \text{Volumi i Tregtimit DAM në orën } h}{\sum_h \text{Konsumi në orën } h}$$

ku h është çdo orë në periudhën për të cilën do të kryhet vlerësimi.

1. ERE do të analizojë metodologjinë e ACER për llogaritjen e faktorit të qarkullimit që zbatohet për tregjet krahasuese për të vlerësuar përshtatshmërinë e treguesve të publikuar për t'i krahasuar me faktorin e qarkullimit të Bursës Shqiptare të Energjisë. Krahasimi mes tregjeve të ndryshme duhet të marrë parasysh volumet e tregtuara në tregun e ditës në avancë nëpërmjet bursave kundrejt mënyrave të tjera të tregtimit.
2. Me qëllim ofrimit të një vlerësimi gjithëpërfshirës të gatishmërisë së tregut, ERE përveç treguesve të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, mund të marrë në konsideratë dhe treguesit si më poshtë vijon, ku zbatueshmëria e tyre do të varet nga disponueshmëria e të dhënave për analizën e synuar krahasuese:

- a) **Diferenca mes kërkesës dhe ofertës**, e cila përkufizohet si diferenca mes çmimit minimal të pasuksesshëm të kërkesës (në shitje) dhe çmimit maksimal të pasuksesshëm të ofertës (në blerje). Diferenca midis ofertës dhe kërkesës pasqyron kostot e transaksionit të lidhura me një ndryshim të menjëhershëm në pozicionin kontraktual të pjesëmarrësve në treg. Për rrjedhojë, kjo diferencë ofron një matje të drejtpërdrejtë të likuiditetit në terma të aftësisë së pjesëmarrësve në treg për të tregtuar vëllime marginale shtesë të energjisë pa ndikuar ndjeshëm në çmim. Për të llogaritur diferencat ofertë-kërkesë, është e nevojshme të mbledhen të dhëna mbi kurbat agregate orare të ofertës dhe kërkesës në tregun përkatës të ditës në avancë. Në mungesë të të dhënave për kurbat agregate, këto mund të llogariten nga informacioni mbi ofertat individuale të blerjes dhe shitjes. Pas analizës së diferencës

Miraturar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 06.11.2025

mes ofertës dhe kërkesës nga ALPEX dhe vendet e krahasimit, ERE do të përcaktojë matjen më të përshtatshme të diferencës ofertë-kërkesë për krahasim, e cila mund të shprehet ose si një diferencë absolute (e rishikuar me inflacionin sipas nevojës) ose si një përqindje relative e çmimit mesatar në çdo treg.

- b) **Thellësia e tregut**, i cili është një tregues i cili mat madhësinë e transaksioneve tregtare që mund të realizohen me diferenca të vogla midis ofertës dhe kërkesës. Matja e thellësisë së tregut mund të ofrojë më shumë informacion mbi likuiditetin e tregut sesa thjesht diferenca midis ofertës dhe kërkesës, pasi kjo matje merr parasysh vëllimin e ofertave të blerjes/shitjes që mund të hasen në treg. Në kuadër të vlerësimit të gatishmërisë së tregut, ERE duhet të marrin parasysh nëse thellësia e tregut mund të akomodojë burimet e rinovueshme, sipas rradhës së meritës, bazuar në kërkesën në sistem si dhe duhet të përqendrohet mbi çështjen nëse kapaciteti i burimeve të rinovueshme, që pritet të përfshihet në skemën mbështetëse të KpD, do të jetë në gjendje të tregtohet në Tregun e Ditës në Avancë me një çmim jo-negativ.

3. ERE do të vlerësojë aplikimin si dhe zbatueshmërinë e rregullave që garantojnë integritetin dhe transparencën në tregun shqiptar të ditës në avancë, përfshirë për personat që organizojnë profesionalisht transaksione bazuar në “Rregulloren për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë REMIT”, miratur nga Bordi i ERE-s dhe sipas rastit në përputhje me kuadrin rregullator të Komunitetit të Energjisë. ERE do të shqyrtojë elementët si më poshtë:

- a) Sjelljen dhe regjistrimin e pjesëmarrësve të tregut, duke vlerësuar nëse të gjithë personat që merren profesionalisht me organizimin ose ekzekutimin e transaksioneve janë të regjistruar dhe veprojnë sipas përcaktimeve të rregullores së ALPEX dhe kuadrit ligjor në fuqi. Kjo pjesë e vlerësimit do të përfshijë verifikimin e procedurave të regjistrimit të pjesëmarrësve në regjistrin kombëtar të REMIT.
- b) Publikimin e të dhënave të tregut duke përfshirë vlerësimin e afateve dhe mjaftueshmërinë e publikimit të informacioneve të brendshme si dhe të njoftimeve urgjente të tregut. ERE do të konfirmojë gjithastu aplikimin e praktikave më të mira të transparencës pas-tregtimit.
- c) Administrimin dhe pavarësinë e ALPEX duke përfshirë shqyrtimin e rregullores së ALPEX me qëllim garantimin e transparencës dhe integritetit operacional, për të informuar konsumatorët si dhe për vlerësimin e përmbushjes së përgjegjësisë së ALPEX për të raportuar sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
- d) Zbatimi i REMIT, përfshirë këtu monitorimin e manipulimeve të tregut si dhe tregtimit me informacion të brendshëm, si dhe një mekanizmi efektiv penalitetesh dhe hetimesh. ERE do të shqyrtojë proceset e monitorimit dhe mbikëqyrjes së tregut nga ALPEX në lidhje me tregun e ditës në avancë të rregulluar sipas rregullave të tregut.

Neni 6

Hartimi i raportit mbi vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë elektrike të ditës në avancë

1. Vlerësimi i parë i gatishmërisë së tregut do të kryhet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj metodologjie.
2. Hartimi i raportit mbi vlerësimin e gatishmërisë së tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike, do të bëhet duke marrë në konsideratë faktorët e përcaktuar në nenin 5 të kësaj metodologjie.

Miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 06.11.2025

3. Pas kryerjes së vlerësimit të parë të gatishmërisë së tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike, ERE harton çdo 6-muaj raportin mbi vlerësimin e gatishmërisë së tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike, deri në një vlerësim pozitiv mbi gatishmërinë e tregut.

Neni 7

Zgjedhja e Vendeve Krahasuese të Bashkimit European

1. ERE do të krahasojë faktorët e qarkullimit me nivelet e vëzhguara në bursat e tjera të energjisë elektrike në Bashkimin European, sic përcaktuar në ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.
2. Në kryerjen e vlerësimit të gatishmërisë së tregut të ditës në avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë nga ERE, me qëllim lehtësimin e konvertimit të MBE-ve në KpD, krahasimi duhet të kufizohet në tregjet e ditës në avancë të vendeve të BE-së, të cilat kanë futur kontratat për diferencë.
3. Likuiditeti i Tregut Shqiptar të Ditës në Avancë duhet të vlerësohet kundrejt treguesve të likuiditetit të tregjeve të Ditës në Avancë përkatëse të BE-së, për periudhat kur është implementuar “Kontrata për Diferencë”.

PJESA III

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 8

Rishikimi dhe ndryshimi i metodologjisë

Kjo metodologji është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të bordit të ERE, në përputhje me Rregulloren për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo metodologji hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.